



Datë: 17.11.2025
Numër Protokolli: 7392/2025

A.nr.1307/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedura sipas ankesës me numër A.nr.1307/2025, të datës 07.07.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit: Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 17.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1307/2025, e datës 07.07.2025, e parashtruar nga ankuesi G.H.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 3631 i datës 24.06.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues në procedurën me numër të referencës: RN00017976, për pozitën Zyrtar i Autorizimit të Pagesave.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, G.H (*tutje referuar: Ankuesja*), me datë 07.07.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë kundër procedurës së pranimit më nr. reference: RN00017976, për pozitën Zyrtar i Autorizimit të Pagesave të shpallur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë (AZHB), ndërsa, kjo e fundit, më datë 18.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4534/2025 të datës 07.07.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Formularët e vlerësimit të intervistës dhe jetëshkrimit për ankuesin datës 24.06.2025; Njoftimin e datës 17.04.2024; Formularët e vlerësimit të intervistës për ankuesin datës 17.04.2024 dhe 09.09.2024; Njoftimin e datës 10.09.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 18.07.2025; Konkursin me Nr. reference: RN00017976 për pozitën Zyrtar i Autorizimit të Pagesave; Listën e aplikantëve; Njoftimin me numër protokolli 3631 të datës 24.06.2025, për kandidatin fitues; Vendimin e datës 20.06.2025 për themelimin e komisionit të pranimit dhe akt emërimet/vendimet e anëtarëve të këtij komisioni; Aplikacionin e ankuesit të datës 13.06.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-35; Aplikacionin e datës

14.06.2025 të kandidatës A.Sh me dokumentacionin faqe 1-36; Formularët e vlerësimit të intervistës dhe jetëshkrimin të datës 24.06.2025 për ankuesin dhe kandidaten fituese.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se AZHB-ja më datë 12.06.2025 ka shpallur konkursin me nr. reference: RN00017976, me emrin e Grupit Administrim i Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës *“Zyrtar i Autorizimit të Pagesave”*, për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme, me afat aplikimi nga data 13.06.2025 deri më datë 19.06.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton së në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej trembëdhjetë (13) kandidatë, ndërsa, verifikimin paraprak e kanë kaluar tetë (8) kandidatë, mesin e tyre edhe ankuesi dhe së i njëjta i është nënshtruar intervistës me gojë, mirëpo, sipas njoftimit me numër protokolli 363, të datë 24.06.2025, rezulton së ankuesi nuk ka rritur të shpallet kandidat fitues, gjegjësisht, kandidatja A.Sh është deklaruar si kandidate fituese me 74.69 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e procedurës më nr. reference: RN00017976, duke pretenduar së vlerësimi i jetëshkrimit nuk ka qenë korrekt dhe ka pasur dallim në raport me konkurset paraprake ngase nuk jam vlerësuar me pikët sipas rregullatës. Kërkon të shikohet nëse kandidati fitues ka qenë më i vlerësuar, të konstatohet se pse në konkurset tjera janë vlerësuar me pikë maksimale në jetëshkrim në raport me këtë proces.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017976 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës *“Zyrtar i Autorizimit të Pagesave”*, si kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore Kolegji iu referuar dispozitave të nenit 37 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton: **1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj. 3. Përfundimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 3.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 4. Kontrata e punës për periudhë të caktuar sipas paragrafit 3. të këtij neni, lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.1. të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.2. të këtij neni. 5. E/i punësuar/i me kontratë sipas paragrafit 3. të këtij neni, gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit civil, me përjashtim të së drejtës për vazhdim të kontratës së përkohshme, pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit.**

Rrjedhimisht, në trajtim të drejtë të çështjes ankimore Kolegji mori parasysh edhe rregullativen ligjore të përcaktuar më Rregullores (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, më theks të veçantë:

-Nenin 4: 1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3 / 12 1.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 1.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 2. Kontrata e punës për periudhë të caktuar lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nën paragrafit 1.1 të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nën paragrafit 1.2. të këtij neni. 3. I punësuari me kontratë sipas këtij neni, nuk gëzon të drejtën për vazhdim të kontratës së përkohshme, që tejkalon afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

-Nenin 7: 1. Kërkesa për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme duhet të arsyetohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i pozitës dhe të miratohet nga Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit. 2. Kërkesa për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për projekt të caktuar aprovohet nga titullari i institucionit. 3. Procedurat e përzgjedhjes për pozitën me kontratë për një periudhë të caktuar zhvillohen nga NjMBNj e institucionit përkatës. 4. Themelimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme bëhet për kategorinë profesionale dhe të specialistit nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur, publike, në përputhje me parimet e përcaktuara në LZP. 5. Shpallja e procedurës së përzgjedhjes për pozitë bëhet nga NjMBNj në SIMBNj, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve nga kandidatët për pranim në shërbimin civil bëhet sipas afatit të përcaktuar në shpallje, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se shtatë (7) ditë. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimin paraprak e bën NjMBNj e institucionit që zhvillon procedurën e përzgjedhjes ndërsa vlerësimin profesional e bën Komisioni i Përzgjedhjes. 9. Në procedurën e verifikimit paraprak kandidatët nuk vlerësohen me pikë, ndërsa në vlerësimin profesional mund të vlerësohen deri në njëqind (100) pikë.

Referuar kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit në ndërlidhje me provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë dhe si rrjedhojë nga analizimi i formularëve të vlerësimit të intervistës ka ardhur në përfundimin se vlerësimi i jetëshkrimit lidhur me arsimin dhe përvojën e punës ishte bazuar në notën mesatare të kandidateve të arritur në studime themelore, dhe përvojës relevante lahur me pozitën e shpallur. Rrjedhimisht, ankuesi sipas Diplomës me nr.1349, të datës 05.11.2020, ka notë mesatare të studimeve 6.81, dukë u vlerësuar më 6.81 pikë, ndërsa, kandidatja fituese sipas diplomës nr.6759, të datës 09.01.2020, ka notë mesatare të studimeve 6.36, duke u vlerësuar më 6.36, pikë, pra, referuar vlerësimit të arsimit, nuk vërehet diskriminim i ankuesit në raport me kandidaten fituese. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës ankuesi është vlerësuar më nga 7 pikë, ndërsa kandidatja fituese me 10 pikë. Gjegjësisht, ankuesi sipas referencës të datës 30.06.2022, të lëshuar nga biznesi “Frutaria” SHPK, i njëjti ka punuar në këtë kompani në pozitën Zyrtar për kontrollimin e parave në njësi ne periudhën kohore 20.04.2020 deri 30.06.2022; sipas vërtetimit të datës 17.12.2024, të lëshuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ankuesi ka punuar ne Projektin për Regjistrim të Popullsisë, si mbikëqyrës aktiv për periudhën kohore 22.03.2024 deri 04.06.2024, si dhe letër referencën e datës 06.12.2022, të lëshuar nga kompania “BAS”, më të cilin konfirmohet se ka punuar në këtë kompani si zyrtar për financa në periudhën 01.09.2022 deri 30.11.2022. Ndërsa, kandidatja fituese sipas Certifikatës së datës 15.06.2020, të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, e njëjta ka përfunduar praktiken në këtë ministri nga data 13.08.2019 deri 12.06.2020, sipas Marrëveshjes për Angazhim në Punë praktike të datës 05.08.2020, e njëjta nga data 01.0.2020 deri me datë 31.01.2021 ka punuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, sipas kontratës të datës 01.05.2023, të lidhur me OJQ” Retina” e njëjta ka punuar si koordinatorë për Administratë dhe Logjistike, nga data 01.05.2023 deri 30.08.2025. Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më sipër, Kolegji vlerëson se ankuesi ka përvojë relevante të punës, dhe së i njëjti po të vlerësohej me 10 pikë ashtu sikurse kandidatja fituese, nuk do te arrinte numrin e pikëve të nevojshëm për tu konsideruar si kandidatë më shumë pikë, pasi

që, kandidati fitues ka arritur të grumbulloj më shumë pikë të vlerësimit tek pyetjet e parashtruara nga anëtarët e komisionit vlerësues, andaj, mbi këto rrethana pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk ka mbështetje.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së ankuesi dhe kandidati fitues kanë plotësuar kriteret formale, e duke qenë së nuk është vërtetuar ndonjë shkelje procedurale dhe materiale në procedurën e kontestuar, rezulton së procesi sipas konkursit me nr.reference RN00017976 është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregulloren (QRK) Nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar.

Thënë si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër: A.nr.1307/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit G.H;
- Organit të punësimit: Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në AZHB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.